



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:222823

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05739861

P.nr.494/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, Departamenti i përgjishëm-Divizioni penal në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit J. S. nga L., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5564/23 të datës 11.10.2023, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, jashtë seancës gjyqësore, me datën 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.21/24, e datës 27.05.2024, e lidhur në mes të pandehurit J. S. nga L. dhe të dëmtuarit KEDS Distriktit Ferizaj, e lidhur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.5564/23 të datës 11.10.2023.

III.PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit J. S. nga L., shqiptar, shtetas të Republikës së Kosovës, për shkak se të njëjtit kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësuar.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj Prishtinë PP.II.nr.5564/23 të datës 11.10.2023, e ka akuzuar të pandehurin J. S. nga L., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së. Palët pra, i pandehuri dhe i dëmtuari kanë propozuar që kjo çështje të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit dhe gjykata me dt.02.05.2024 e ka referuar rastin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 27.05.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të t'pandehurit J. S. dhe të dëmtuarit KEDS Distriktit Ferizaj, në prani të zyrtares së ndërmjetsimit të autorizuar nga institucioni i ndërmjetsimit ndërmjetsueses Mevlyde Beka.

Në seancën e ndërmjetësimit palët kanë arritur marrëveshjen me vullnetin e tyre të plotë dhe nuk kontestojnë asnjërën nga pikat e lartshënuara për të cilat pajtohen njëzëri.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me datën 27.05.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve me numër Nd.nr.21/24, të nënshkruar me të datën 27.05.2024, për zgjidhjen e ndërmjetësimit.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN
P.nr.494/23, të datës 27.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

Gjyqtari
Avdirrahman Gashi

UDHEZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.